



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

Nr. 2/33

Datë: 27.07.2020

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 4 dhe 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike si dhe nenit 36 të Rregullores Nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Kushtet e përgjithshme për aplikim në studimet themelore bachelor për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike përcaktohen nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike.
2. Kushtet e veçanta për aplikim në studimet themelore bachelor për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike përcaktohen nga Institucionet e Sigurisë Publike mbi bazën e analizës së nevojave për ngritjen e kapaciteteve të brendshme.
3. Institucionet e Sigurisë Publike mbi bazën e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta shpallin konkurs të brendshëm për përzgjedhjen e zyrtarëve që regjistrohen në studimet themelore bachelor në sigurinë publike në AKSP.
4. Institucionet e Sigurisë Publike pas përfundimit të procesit të konkursit të brendshëm, dërgojnë listat e zyrtarëve të përzgjedhur së bashku me dokumentet përkatëse për regjistrim në AKSP sipas kuotave të përcaktuara nga Bordi i AKSP-së.
5. Obligohen Institucionet e Sigurisë Publike dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nehat Thaqi

Kryesues i Bordit

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit;
- AKSP, PK, DK, AME, SHKK, SHSK, IPK;
- Arkivit të AKSP-së.